



Federata Aeronautike e Kosovës

RREGULLORE PËR MBARËVAJTJEN E PUNËS NË FEDERATËN AERONAUTIKE TË KOSOVËS

Kryesia e Federatës Aeronautike të Kosovës në mbledhjen e vet të mbajtur më 29.10.2015, aprovoi:

RREGULLOREN 05/2015

RREGULLORE PËR MBARËVAJTJEN E PUNËS NË FEDERATËN AERONAUTIKE TË KOSOVËS

Neni 1.

Qellimi: i kesaj rregulloreje eshte qe te ndihmoj dhe rregulloj kornizat kryesore per mbarevajtjen e FAK-ut. Arsye shtese eshte qe proceset dhe zhvillimi i Federates te mos pengohet ose mbivotohet nga koleget joaktiv por te dominoj arsyeja e shendoshe dhe vullneti i shumices per formalizimin e funksionimit te Federates. Fillimisht duam qe te definojme se cka nenkupton klub apo antar aktiv, shpenzimet e Federates, menyren e raportimit te klubeve me federaten etj. Tani keto ndryshime dhe rregulla jane me se te domosdoshme sidomos pas antaresimit ne Federaten Aeronautike Nderkombtare FAI (Shtator 2015)

Neni 2.

Aeroklub Aktiv: Nenkupton nje klub qe ka dokumentacionin perkates valid te dorezuar ne Federate dhe qe ka aktivitet se paku ne nje nga sportet rekreative te Aeronautikes si :Paragllajdzimem, velorizem, parashutizem, modelar, ballona me ajer, Delta plan etj. Aeroklubi duhet t'i kete se paku tre antare aktive dhe te kete te paguar antaresine ndaj Federates per vitin e kaluar. Aeroklubet duhet ti kene aktivitetet e kordinuara me federaten dhe te kujdeset qe anteret e vet mos te demtojne reputacionin dhe imazhin e klubit apo federates ne aktivitetet e ndryshme sportive te organizuara brenda apo jashte vendit.

Nje klub duhet qe se paku nje here ne dy vite te organizoj nje gare sportive ne kuader te Kampionatit Kombetar apo jashte saj. Eshte e lejuar qe dy klube te bashkorganizojne nje ngjarje te perbashket sportive. Nese keto kushte nuk permbushen atehere aeroklubi shendrrrohet ne pasiv dhe nuk ka te drejta qe i takojne ne kuader te federates deri ne vendimin e ardhshem te Kryesise se Federates. Pas shenderrimit te aeroklubit ne pasiv, klubi duhet te kerkoj nje lutje me arsyetime she planin e aktiviteve per te ardhmen me kusht qe te aprovet kerkesa per shendrrim ne aeroklub aktiv. Pilotet aktiv te ndonje klubi pasiv duhet te regjistrohen ne ndonjeren nga aeroklubet tjera aktive ne Kosove ose nuk kane mundesi te marrin pjese ne garate organizuara nga FAK.



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 3.

Anetar Aktiv ne organet e FAK-ut: Cilido person apo individ qe ka nje post zyrtar te zgjedhur apo emeruar ne Federate eshte i obliguar ta kryej me perpikmeri, vullnet dhe afat te caktuar kohor detyrat pergjegjese qe i takojne, ne te kunderten te dorezoj mandatin me qellim qe Federata me aktivitetet e veta te ece perpara dhe t'i liroje vendin kolegeve tjere qe kane dijeni, vullnet dhe kohe te mjaftueshme. Pra, cdo antare kryesie, nenkryetar, sekretar, kryetar komisioni etj. qe ka post zyrtar ne c'faredo organi drejtues te FAK-ut mungon tri here ne mbledhjet e thirrura ateher ai post i tij/saj behet pasiv dhe ngrihet deri ne zgjedhjen e organeve te reja ne kuvendin e pergjithshem qe mbahet nje here ne vit.

Neni 4.

Antaresia e klubeve ne Federate: Federata Aeronautike e Kosoves e ka te percaktuar tarifen prej 60 (Gjashtedhjete) Euro per vit kalendarik e cila nuk duhet te paguhet me vone se 31 Mars te vitit pasues ne llogarine e Federates. Shembull anataresia per vitin 2015 nuk duhet te kaloj 31 Marsin e vitit 2016. Kjo eshte shume simbolike por jetike per mbarevajtjen e aktiviteteve te FAK-ut pasi qe ne te njejten kohe edhe aeroklubet marrin perkrahje ne fusha te ndryshme nga Federata.

Neni 5.

Pilot Aktiv: Nenkupton cdo person qe mirret me njeren nga sportet aeronautike dhe qe ka licence valide per ate sport. Shembull nje paragllajdist nuk mundet te konsiderohet pilot aktiv nese nuk ka licence valide qe leshohet nga Autoriteti i Avicacionit Civil te Kosoves. Gjithashtu licence vjetore per gara nga FAI nuk mund te kete askush qe nuk ka licence nga institucionet Kosovare. Ne garat e organizuara nen patronatin e Federates nuk mundet askush te marre pjese si garues pa licence valide pervec si mysafire dhe rezultatet e tij nuk do te llogariten ne perfundim te gares. Per pjesemarrjen si mysafire nevojitet pelqimi i aeroklubit organizator. Cdo pilot aktiv duhet te kete dokument identifikimi i leshuar nga Federata Aeronautike e Kosoves

Nje kusht shtese eshte qe nje pilot aktiv te marre pjese ne se paku dy aktivite sportive te organizuara nga federata apo gara nderkombetare gjate nje viti kalendarik.



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 6.

Nxenes/Pilot: Konsiderohet cdo individ qe eshte i interesuar te mesoj ose eshte ne proces per njerin nga sportet e fluturimeve. Nxensesi duhet te regjistrohet ne njerin nga klubet aktive dhe te informohet sekretari i federates jo me larg se 10 dite pune nga fillimi i ushtrimeve dhe te njoftohet se kush eshte tutor apo instruktor pergjegjes per ate nxenes. Gjithashtu nxenesi duhet te pajiset me dokument identifikues nga federata.

Neni 7.

Shpenzimet e Federates: Duhet te jene sa me racionale dhe dhe te domosdoshme ne dobi te federates. Shuma e lejuar e shpenzimeve ne kuader te Federates eshte si me poshte:

a) Kryetari i Federates personalisht deri ne 200 Euro ne vit

b) Kryetari i Federates dhe sekretari deri ne 1000 Euro per transakcion por jo me shume se 5000 euro ne vit. Per kete kategori te shpenzimeve njoftohet edhe kryesia me e-mail paraprakisht.

c) Kryesia e Federates me shumice te thjeshte aprovon te gjitha shumat mbi 1000 Euro per transakcion apo 5000 Euro vjetore ne total.

Neni 8.

Raportimet e Klubeve: Duhet te behen ne te shkruar dhe permes kontakteve zyrtare te Federates. Cdo klub duhet te raportoje dy here ne vit domethene ne fillim te Korrikut dhe Janarit per emrat e antareve te vet, numrin personal, llojin e sportit, e-mailin zyrtar dhe numrin e telefonit. Raporti te behet per periudhen e fundit te Qershorit dhe per gjendjen ne fund te Dhjetorit. Klubet mund te njoftojne vetem per ndryshimet qe kane ndodhe ne krahasim me gjysmevjetorin e kaluar. Klubet duhet te kontaktojne me shkrim ne e-mail adresat zyrtare si me poshte varesisht prej natyres te porosisë:

- info@aeronautika.org
- sekretari@aeronautika.org
- kryesia@aeronautika.org
- klubet@aeronautika.org



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 9.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyre dhe procedurë të njejtë sikur me rastin e miratimit të saj, pra ndryshimet propozohen nga komisioni për paragllajdzëm në kuadër të FAK si dhe dëgrohen për votim në kryesinë e FAK.

Neni 10.

Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit.

Prishtinë, 29.10.2015

Fadil Gergur

Shkelqim Krasniqi

Florie Hajra

Arben Gjokolli

Afrim Aziri

Berat Bejtullahu

Ardall Celina

Sabahudin Bytyci

Gezim Statovci

Petar Joksimovic